

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Rama përballë drejtësisë që reformoi - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/rama-perballe-drejtjesise-qe-reformoi/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:40:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 19:01:01 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2e3ac02c575ab26d4847d1e6e98579078efa7e74fd7013540cf36ee204646ee2
TEKSTI	443aef83f47e21031e89db62d37e0a0e9d063edac657b509a00a218ae59246f8
PAMJA	a8949ea3cb13e9bc4a2687f24642925758a916f054ee9482a3d0c49f47976a1c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6cad96720d1f735c6a3a64d4aca948d23f1b13da4e3d566ecaad96b908d96ba7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6cad96720d1f735c6a3a64d4aca948d23f1b13da4e3d566ecaad96b908d96ba7>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Rama përballë drejtësisë që reformoi

by Bota Bota — September 15, 2026 in Aktualitet, Kryesore, Politike

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Tentativa e tretë e dështuar e kryetarit të Bashkisë së Tiranës për liri, i cili prej 19 muajsh drejton kryeqytetin nga qelia, u komentua nga kryeministri Edi Rama menjëherë pas vendimit të Gjykatës së Lartë.

Në një **postim** në rrjetet sociale, Rama e konsideroi rastin të paprecedentë, madje unik në historinë evropiane. Kryetari i zgjedhur i një qyteti, sipas tij, mbahet në burg, ndërsa vijon të jetë në detyrë.

"Përsëri Tirana pa kokë dhe përsëri kryetari i zgjedhur e i pagëzuar rishtas nga vetë Kushtetuesja si i vetmi në detyrë dhe i palëvizshëm nga detyra, nuk mund të lëvizë nga qelia ku mbahet pa gjyq", shkroi Rama.

Erion Veliaj mbahet në burgun e Durrësit që prej 10 shkurtit 2025, nën akuzat e SPAK-ut se ai dhe bashkëshortja e tij kanë përfituar rreth 1 milion euro para publike, të cilat, sipas akuzës, janë përdorur për bizhuteri e veshje dhe janë kanalizuar përmes një rrjeti organizatash jofitimprurëse.

Këto, së bashku me 13 akuzat e ngritura nga SPAK-u, bënë që Gjykata e Lartë të rrëzonte kërkesën për zbutjen e masës së arrestit dhe të linte Veliajn në qeli. Por vendimi i gjykatës dukshëm nuk gjeti mbështetjen e kryeministrit.

Rama mbështeti kërkesën për lirim të kryesocialistit të Tiranës, duke e përligjur këtë qëndrim me kostot që, sipas tij, burgosja e Veliajt po i shkakton kryeqytetit dhe qytetarëve.

"Askush s'po do t'ia dijë për koston përditë e më të lartë të të parit kryeqytet në botë, që prej thujse dy vjetësh jeton me kokë të prerë dhe për haraçin që thujse 1 milionë banorë duhet t'i paguajnë përditë këtij eksperimenti të paparë e të padëgjuar juridik, social dhe ekonomik", shkruan Rama.

Por qëndrimi i Ramës në këtë rast nuk është i njëjtë me atë që kryeministri ka përsëritur prej vitesh: se ai nuk i komenton vendimet e gjykatave.

"Rastet unike" në botë të qeverisë Rama

TË FUNDIT

Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktimë ndëshkohen njësoj

SEPTEMBER 15, 2026

"Rama e çoi Veliajn në burg"/ Hoxha: Ai është përgjegjësi kryesor për drejtësinë që kemi sot

SEPTEMBER 15, 2026

Rama përballë drejtësisë që reformoi

SEPTEMBER 15, 2026

Sytë nga Haga/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet "Flakët e Lirisë"

SEPTEMBER 15, 2026

"Nuk kam bërë asgjë të gabuar"/ U arrestua pas akuzave për sulm, udhëheqësi i Reform UK në Uells jep dorëheqjen

SEPTEMBER 15, 2026

Tre të vrarë nga të shtënat me armë në një dyqan në ...

SEPTEMBER 15, 2026

"Daja i deputetes më ka përdhunuar"/ Pas akuzës së 34-vjeçares reagon Zegjine Caushi

SEPTEMBER 15, 2026

Pankarta pa doreza kundër Ramës/ "Me ç'fytirë pushtetit i ngjitesh?"

SEPTEMBER 15, 2026

"Arrestoni Ramën"/ Protesta përshkallëzohet, turma marshon drejt Kryeministrit

SEPTEMBER 15, 2026

Sot protesta e 108-të kundër Ramës, qytetarët rikthehen në shesh

SEPTEMBER 15, 2026

"Vendimi i sotëm nuk komentohet, vetëm respektohet", do të deklaronte Edi Rama në fundpranverën e vitit 2018, pasi Gjykata e Krimeve të Rënda vendosi masën e arrestit shtëpiak për Saimir Tahirin, në atë kohë ministër i Brendshëm dhe një prej bashkëpunëtorëve më të afërt të kryeministrit.

Në vitet që pasuan, kjo u kthye në një togfjalësh të përsëritur nga kryeministri, sa herë që drejtësia merrte vendime që preknin zyrtarë të lartë socialistë.

Ky qëndrim u bë edhe më i prerë pas krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në një përpjekje për të përcjellë mesazhin se proceset gjyqësore përbënin një proces të pavarur jashtë influencave politike.

Ndërsa reforma në drejtësi zinte një vend qendror në fjalimet e kryeministrit si një prej arritjeve kryesore të qeverisjes së tij, rritja e numrit të zyrtarëve të lartë që po përballen me drejtësinë duket se po e sfidon gjithnjë e më shumë këtë narrativë.

Ditën e sotme, ai sërish e rikujtoi këtë rregull.

"Po, rregulli e do që vendimet e gjykatave të respektohen dhe unë i nënshtrohem gjithnjë këtij rregulli, madje as nuk i komentoj vendimet përpara formës së prerë", tha ai.

Megjithatë, ndryshe nga ç'kërkon rregulli, ai e komentoj, dhe ky nuk ishte rasti i vetëm që kryeministri shkeli rregullin e vënë vetes.

Në shkurt 2026, ndërsa SPAK-u kërkoi heqjen e imunitetit të ish-zëvendëskryeminstres dhe ministres së Infrastruktursë dhe Energjisë, Belinda Balluku, nën dyshimet për kryerjen e katër veprave penale, Edi Rama doli publikisht kundër veprimit të Prokurorisë së Posaçme.

Çështja "Balluku", pas zvarritjeve disamujore dhe dështimeve të mbledhjeve të Këshillit të Mandateve dhe Imunitetit, mbërriti edhe në Gjykatën Kushtetuese, pas një ankimi të depozituar nga vetë kryeministri.

Edhe këtë herë, **argumenti** i përdorur për të përligjur ndërhyrjen ishte "interesi publik", ndërsa masa e SPAK-ut për pezullimin e Ballukut nga funksioni i ministres u cilësua nga Rama si "rasti i pandodhur kurrë në botë".

"Një masë absurde, që siç e kemi shpjeguar më parë, pezulloi faktikisht funksionin, jo thjesht personin, prandaj edhe nuk ka ndodhur kurrë dhe askund tjetër në botë, një budallallëk i kësaj natyre", deklaroi Rama.

Me shtimin e viteve dhe të zyrtarëve të lartë që përballen me drejtësinë, duket se respektimi i rregullit të kryeministrit për të mos komentuar vendimet gjyqësore po bëhet gjithnjë e më i vështirë.

Kjo duket se ka impaktuar edhe narrativën e kryeministrit kundrejt sistemit të drejtësisë. Ajo që për kryeministrin ishte "meritë ekskluzive e vullnetit të tij politik", në kundërshtimet për rastin Balluku, kërkesat e gjyqtarëve i cilësoi si "marrëbëzëri", "skandal logjik, moral, ligjor dhe kushtetues" e madje një vendim në favor të tyre do të ishte një "turp kombëtar".

Në qëndrimet e tij të fundit, Rama ka mbajtur një qëndrim kundërshtues edhe ndaj ngërçit të krijuar me pagat e magistratëve.

Ai ka kundërshtuar vendimmarrjen e KLGJ-së dhe KLP-së për zbatimin e formulës së re të pagave, duke e cilësuar atë si një vetëautorizim institucional të paligjshëm dhe duke argumentuar se askush nuk mund ta urdhërojë Parlamentin se si duhet të votojë. /Xhesika Tollia – Shteg.org

Tags: Edi Rama Erion Veliaj Reforme ne drejtesi

Previous Post

Sytë nga Haga/ Pak orë para vendimit për ish-krerët e UÇK-së, në Prishtinë ndizet "Flakët e Lirisë"

Next Post

"Rama e çoi Veliajn në burg"/ Hoxha: Ai është përgjegjësi kryesor për drejtësinë që kemi sot



Bota Bota


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarën

0 SHARES



Identifikohet shqiptari i vrarë në Itali/ E lidhën dhe e ekzekutuan në makinë, automjetin më pas e hodhën në lumë

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.